



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "SolviT" Sh.P.K. të datës 03.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT - Tabela Digjitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "SolviT" Sh.P.K. të datës 03.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT - Tabela Digjitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "SolviT" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 03.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT - Tabela Digjitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi 1 - Qëllimi i projektit është humbur

Aktiviteti i prokurimit me titull "168 Pajisje IT – Tabela Digjitale" synon, sipas vetë titullit, furnizimin e shkollave të Komunës së Prishtinës me tabela digjitale, si qëllim parësor i këtij projekti. Megjithatë, gjatë analizës së dokumentacionit të tenderit, është e qartë se vëmendja kryesore nuk i është kushtuar pajisjeve që lidhen me funksionalitetin e tabelave digjitale, por një sërë pajisjesh të tjera dytësore si switch, firewall, kanale për kablo etj., të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me funksionimin e tabelave SMART.

Ne, si partner të certifikuar të prodhuesit lider botëror të tabelave digjitale – SMART Technologies, ndjehemi thellësisht të diskriminuar dhe të dëmtuar nga kjo qasje, pasi vetë komponenti thelbësor i projektit – furnizimi me tabela SMART – është vendosur në plan të dytë, pa peshën dhe vlerësimin e duhur teknik e financiar.

Për më tepër, përfshirja e pajisjeve të njetit në këtë aktivitet, së bashku me kërkesat për autorizime nga prodhuesit për ato pajisje, i penalizon të gjithë operatorët ekonomikë që janë të specializuar vetëm në zgjidhjet me SMARTBoard, përfshirë edhe ne si përfaqësues zyrtarë të këtij prodhuesi.

Ky veprim i AK-së jo vetëm që na penalizon neve si operatorë ekonomikë të interesuar, por në të njëjtën kohë dëmton edhe vetë interesin publik – shkollat dhe nxënësit e Komunës së Prishtinës – duke devijuar nga qëllimi kryesor i projektit.

Apelojmë që këto kërkesa të rishikohen me urgjencë dhe të rikthehet fokusi te qëllimi fillestar i projektit: furnizimi i shkollave me tabela SMART, si mjetet kryesore për përmirësimin e procesit mësimor në kuadër të këtij investimi publik. Kërkojmë që tabelat të vendosen në LOT të vecantë, ndaras me paisjet tjera që nuk ndikojnë në funksionalitetin e tyre.

AK – Konsideron se pretendimi 1 është i pabazuar.

Përgjigja nga AK për P.1. – Qëllimi i projektit është:

- a) Furnizimi me Tabela të Mençura apo SMART BOARD
- b) Ndërtimi i Infrastrukturës për funksionalizim të Tabelave të mençura
- c) Menaxhimi i Tabelave të Mençura përmes infrastrukturës
- d) Mbrojtja nga sulmet kibernetike të mundshme nga jashtë

Pretendimi 2 — Shkelje e parimeve të konkurrencës dhe trajtimit të barabartë, mosndarja e pozicioneve ne LOTE

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar, veçanërisht në dispozitat që rregullojnë ndarjen e kontratave në lote, ju drejtohem me këtë kërkesë për ndarje të paisjeve në LOTE.

Bashkimi i paisjeve të ndryshme në një kontratë të vetme është në kundërshtim me:

- Nenin 7 (1)-(3) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (parimi i barazisë në trajtim dhe mos-diskriminimit);
- Nenin 6 të të njëjtit ligj (parimi i ekonomicitetit dhe efikasitetit).

Në dosjen e tenderit për këtë aktivitet, është vërejtur se pajisjet e kërkuara janë bashkuar në një kontratë të vetme, ndonëse ato nuk kanë ngjashmëri ndërmjet veti dhe përbëjnë kategori të ndryshme mallrash/shërbimesh.

Shembull, në kete aktivitet te prokurimit kerkohet qe krijohet edhe infrastruktura e rrjetit, ku kerkohen 1. Produkte si te rrjetit si UTP KABLLO, Access Point dhe Switch, 2. Paisje elektrike si Siguresa Rryme dhe kablo rryme, 3. Material industrial si Kanalina, Ankerat per montim ne beton, lidhese te kabllave etj dhe 4. Tabela Digjitale (Smartboards) qe nuk jane kategori e njejte/ngjajshme me asnjeren nga kategorite e cekura me larte.

5/3

F02 Formulari Standard per nishqyrtim te vendimit ne AK

Kjo mënyrë e grupimit kufizon konkurrencën. Përfshihet operatorët ekonomikë që mund të furnizojnë vetëm një kategori të caktuar pajisjesh dhe Nuk është në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë dhe të hapur të operatorëve ekonomikë.

Prandaj, kërkojmë nga autoriteti kontraktues që pajisjet e përfshira në këtë aktivitet të ndahen në lote të veçanta, sipas ngjashmërisë dhe natyrës së tyre, që ne renditjen me larte lehte mund te ndahen deri ne 4 kategori (4 LOTE).

Ne si Operator Ekonomik kemi specializim në montimin e Smartboards (tabelave digjitale), duke ofruar staf të trajnuar për instalimin e tyre si dhe trajnimin për përdorimin e tyre. Produktet dhe shërbimet e tjera të kërkuara në këtë aktivitet prokurimi nuk i përkasin aktivitetit tonë kryesor biznesor dhe na penalizojnë, pasi janë të ndryshme nga ekspertiza jonë dhe nuk përfaqësojnë aftësitë tona profesionale.

Ndarja e paisjeve ne LOTE do të siguronte një proces më transparent, më konkurrues dhe në përputhje me parimet ligjore të prokurimit publik.

Pas ndarjes ne LOTE, kerkojme qe te shtyhet afati i dorezimit te ofertave sepse pasi te nderrohet dosja e tenderit na duhet kohe shtese per pergaditje te dokumenteve qe duhet te dorezohen bashke me oferte.

Ne te kaluaren, ne si OE kemi kryer furnizimin me tabela digjitale per Komunen e Prishtines, ku ne ate rast nuk jane kerkuar produkte/sherbime te tjera qe nuk lidhen me Tabela Digjitale, ndryshe nga ky aktivitet i prokurimit.

AK - Konsideron se pretendimi 2 është i pabazuar.

Përgjigja nga AK për P.2. -

- AK - vleron se vetëm furnizimi me Tabela të Mencura, nuk e përmbush qëllimin e projektit të Sqaruar në pretendimin nr. 1.
- AK - Gjithashtu vleron se ka mjaftushëm OE - që janë në gjendje të implementojnë dhe rrjetat dhe Tabelat e Mencura, për më tepër rregullorja e procedurave të prokurimit lejon dhe "Konserciumet", për të i lehtësuar OE - që të i plotësojnë të gjitha kriteret në konsersium nese nuk arrinë si të vetme.
- AK - Konsideron se kërkesa për të u ndarë ne LOT - e, nuk përbën shkelje të parimeve të konkurences, rrjedhimith rregullores të prokurimit Publik. Ndarja ne LOTE - e, nuk është option që e përmbushë qëllimin e projektit.

Pretendimi 3 - Kërkesat teknike jane diskriminuese dhe favorizojne prodhues te caktuar

Në dokumentacionin teknik të tenderit, kërkesat janë hartuar në mënyrë të tillë që favorizojnë ekskluzivisht prodhues të caktuar, duke përjashtuar në mënyrë të padrejtë konkurrentët e tjerë.

Per shembull, te paisja Firewall Router eshte kerkuar qe paisja te kete teknologjine ClusterXL High Availability.

Teknologjia **ClusterXL** është një veçanti ekskluzive e Check Point, dhe nuk është identike me versionet e prodhuesve të tjerë.

3/3

F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK

Kërkesa për këtë teknologji specifike do të thotë që pajisjet duhet të mbështesin këtë tip të veçantë të disponueshmërisë së lartë që ofrohet vetëm nga Check Point, duke kufizuar kështu mundësitë e konkurrencës me prodhues të tjerë që nuk kanë të njëjtën teknologji.

AK - Konsideron se pretendimi 3 është i pabazuar.

Përgjigja nga AK për P.3. - Kërkesa për teknologjinë ClusterXL High Availability - është teknologji e shpikur dhe e patnetuar nga Check Point, mirëpo si patentë ju është shiturë dhe prodhueseve të tjerë sikurse janë: PaloAlto Networks, Fortinet FortiGate Firewall, Check Point Firewalls, Cisco Firepower, Sophos XG, Juniper SRX Series, Sonic WALL etj. Pra kemi min. 3 Prodhues që e ofrojnë teknologjinë e njëjtë CLUSTER HA. AK Vlerëson se pretendimi ankimorë i OE - SOLVIT, se Teknologjia Cluster HA - Eleminon Prodhuesit të tjerë, nuk qëndron, pasi që janë min. 3 Prodhues që ofrojnë teknologjinë e njëjtë.

Pretendimi 4 - Eshte kerkuar te paraqitet projekt ne MS Visio

Në DT, AK ka kërkuar që Operatori Ekonomik (OE) para ofertimit të përgatisë një plan mostër (shembull) të instalimit të rrjetave në MS Visio dhe ta dorëzojë në zyrat e prokurimit.

Ne e konsiderojmë këtë kërkesë të pakuptimtë dhe të padrejtë, pasi planifikimi i tillë duhet të jetë përgjegjësi e vetë AK-së dhe jo e operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në tender. Kjo praktikë nuk garanton transparencë dhe barazi në procesin e vlerësimit, pasi vlerësimi i një projekti të tillë mund të bëhet në mënyrë selektive dhe subjektive nga ana e AK-së.

Për më tepër, kjo kërkesë mund të krijojë pengesa të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe të kufizojë konkurrencën e lirë dhe të ndershme në tender.

Prandaj, konsiderojmë se kjo kërkesë është hartuar në mënyrë të gabuar dhe kërkojmë që të hiqet menjëherë nga kërkesat e dokumentacionit teknik.

AK - Konsideron se pretendimi 4 është i pabazuar.

Përgjigja nga AK për P.4. -AK ka kërkuar nga ofertuesit një planë mostër, Shembull, për implementimin e projektit me pajisjet Ekzistuese në paramas, për me vlerësu OE – që ka njohurit teknike dhe profesionale për finalizimë të projektitë në fjalë.

Pretendimi 5 - Kërkesa për autorizimet nga prodhuesi/distributori është diskriminuese

Kërkesa që Operatorët Ekonomikë të kenë autorizim zyrtar nga prodhuesi ose distributori për pajisjet, si kablllo dhe switch, është një kriter që rezulton të jetë diskriminues dhe i padrejtë. Kjo sepse favorizon operatorë të caktuar në treg, duke i dhënë atyre një avantazh të paarsyeshëm ndaj konkurrentëve të tjerë që nuk posedojnë një autorizim të tillë, megjithëse mund të jenë në gjendje të ofrojnë produkte dhe shërbime me cilësi të barabartë.

Një kërkesë e tillë kufizon në mënyrë të konsiderueshme konkurrencën dhe pengon pjesëmarrjen e lirë të operatorëve ekonomikë në procesin e prokurimit publik, duke cenuar parimet themelore të transparencës, barazisë dhe konkurrencës së ndershme që duhet të mbajnë drejtimin e çdo procedure të këtij lloji.

Prandaj, kërkojmë që kjo kërkesë të rishikohet dhe të hiqet menjëherë nga AK, në mënyrë që të sigurohet një proces i drejtë, transparent dhe gjithëpërfshirës, ku të gjithë operatorët

4/3

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

ekonomikë me kapacitete të barabarta të kenë mundësi të garojnë në mënyrë të lirë dhe të barabartë.

AK - Konsideron se pretendimi 5 është i pabazuar.

Përgjigja nga AK për P.5. – Kërkesa për autorizime nga prodhuesi është esenciale e domosdoshme, për të siguruar AK – se po lidhë marrëveshje me një OE – që është i Autorizuar nga Prodhuesi për Ri-shitjen e pajisjeve në fjalë. Rrjedhimisht eliminonë OE që potencialisht mundën me u furnizua nga “Grey MARKET”, dhe që potencialisht pajisjet mundë edhe të vijnë pa garancion apo të ri – fabrikua. Prandaj AK – për të ruajtur investiminë dhe për të u siguruar që pajisje sipas paramasës janë me Autorizimë nga Prodhuesi, rrjedhimisht dhe me Garancion nga prodhuesi, vlerëson se AUTORIZIMI është i domosdoshëm. Prandaj si kriterë nuk largohet.

Pretendimi 6 - Peshimi i çmimit nuk është bere ne menyre korrekte dhe te drejte

Në tabelën e vlerësimit të ofertave, peshimi i çmimit është ndarë në tre grupe me pesha të ndryshme: Grupi A (pozicionet 1–34) përfaqëson 50% të peshës totale të çmimit, Grupi B (pozicionet 35–51) zë 30%, ndërsa Grupi C (pozicionet 52–58) mbulon vetëm 20%.

Në të kundërt, produktet kryesore dhe me ndikimin më të madh ekonomik në ofertë janë përfshirë në Grupin C, i cili ka vetëm 20% të peshës së çmimit, duke mos reflektuar kështu rëndësinë reale ekonomike dhe teknike të këtyre artikujve. Kjo mënyrë e peshimit sjell një devijim të konsiderueshëm në procesin e vlerësimit, duke favorizuar ofertat që janë më të lira në produkte me rëndësi të vogël, ndërkohë që produkteve kyçe u jepet një peshë tërësisht disproporcionale në vlerësimin përfundimtar.”

Me kete peshim i humbet komplet kuptimi i projektit, i cili edhe titullin e ka "168 Paisje IT-Tabela Digjitale", kurse ne llogaritje me se pakn peshe kane Tabelat Digjitale.

AK – Konsideron se pretendimi 6 është i pabazuar.

Përgjigja nga AK për P.6. – Renditja e Produkteve sipas Tabelave: Grupi A, Grupi B dhe Grupi C, është bërë sipas prioritetit të punëve dhe të furnizimeve që do të kryhen sipas publikimit të njoftimit me nr. të prokurimit 616-25-69-62-1-1-1 dhe kërkesa për sasi është për 1 njësi, që do të thotë se kërkesa për kabull UTP mundet me qenë 1, 10, 100, 1000, 10 000 etj. Sikurse edhe për pajisje tjera, varet nga vendi "shkolla" ku do të implementohet projekti dhe çfarë sasi nevojitet për me përfunduar shkollën në fjalë, sikurse dhe për pajisje të tjera të Rrjetave Aktive, dhe për SMART Board. Gjithsesi forma e vlerësimit të procedurës së tenderimit për të gjithë OE – është e njëjtë dhe si e tillë nuk përbën shkelje të transparencës apo diskreditim të OE. Dhe si e tillë forma aktuale qendronë.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësine kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 09.09.2025

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.